

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATES 12.10.2023

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 33

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh:33

Këshilltarë gjatë mbledhjes : 35

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita te gjithëve fillojmë këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak me kërkesë te Kryetarit te Bashkisë,do ju lutesha këshilltareve te diskutojnë vetëm rreth kësaj çështje pavarisht se cfarë shqetsimesh ose problematika kërkon te ngrini do jete mbledhja e rradhës qe ne e kemi ne datën 26 ku shqetësimet apo problematikat qe ju keni te akomuluara te ngrihen atë ditë.

Kush eshte dakort me rendin e ditës?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

**PER RIALOKIMIN E FONDEVE PER PERMIRESIMIN E DEKORIT TE QYTETIT,SHTIMIN E AKTIVITETEVE NE FESTAT E FUNDVITITIT ME QELLIM RRITJEN E NUMRIT TE VIZITOREVE ME IMPAKT NE EKONOMINE LOKALE.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni, edhe dicka tjetër ju lutem këshilltareve lidhur me mikofonat neqoftëse nuk e merni fjalën mikrofona të jenë të mbyllur dhe te mos lëvizin sepse dalin jashtë funksionit.

Këshilltar P.Tollkuci: Përshendetje te gjithëve ne ne komision ditën hënë kemi diskutuar në lidhje me këtë material që është paraqitur nga ekzekutivi ne lidhje me rialokimin e fondeve për përmiërsimin e dekorit, shtimin e aktiviteteve per festatat e fundivdit me qëllim numrin e rritjen e numrit te vizitorëve dhe impat ne ekonominë lokale. Materiali i sjellë në moment fillimisht ishte i paqartë për ne atë ditë kemi qene 3 anëtare të komisionit dhe kemi diskutuar me ata pjestarë te ekzekutivit që kanë qënë te pranishëm dhe realisht nga ana jonë si komision nuk është marrë një vendim për votimin apo jo te këtij materiali po dje na është dërguar material shtesë dhe justifikues le te themi nga ana e ekzekutivit te detajuara,te cilat ne sot do bëjmë miratimin në vija të trasha te këtij vendimi dhe me pas pjesët e tjera do i bej ekzekutivi,sigurisht qe me ato justifikim që ekzeutivi ka sjell dhe që ne i kemi diksutuar dhe ne grupin tonë,grupi jonë do ta votojë për unaminitet këtë material për rialokimin e këtij fondi. Faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pyetje rreth këtij materiali ka nga këshilltarët?

Do ju lutesha vetëm njëherë keni te drejtë të beni pyetje pra grumbulloni sa pyetje keni per t'i bërë njëherë.

Këshilltar E.Bregu: Me fal për procedurë,askush nuk ka te drejtë të na heq te drejtën e fjalës me një pyetje apo ku di un.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk thashë të heq te drejtën thash që në lidhje me këtë çështje vetëm njëherë ke te drejtë të bësh pyetje.

Këshilltar E.Bregu: E kuptova e kundërshtoj këtë.

Këshilltar L.Petri: Faleminderit ZNJ. Kryetare,pyetja ime konsition ne lidhje m 3 element qe unë i konsistoj te qendrueshëm për sa i takon dekorit te festave ne tashmë sipas vizionit te bashkisë jemi kthyer 1 qyetet festash dhe elementi i dekorit është nje element i rendesishëm. Unë shoh që fonia,ndricimi dhe skena janë 3 elemente qe përseriten thuaj se kudo si ne pazari si në pedonalia kudo që ka aktivitetet. Sa është e mundur qe Bashkia te bëjë një investim për këto elemente dhe mos krijohet precedenti që gjithmonë të lëshojme me qëra kur vjen puna per këto 3 elemente,njëherë që bëhet ky investim mirëmbahet nga stafi i Bashkisë dhe menaxhohet nga po ky staf mendoj që duhet konsideruar kur te vijë punë për planifikimin e buxhetit te Bashkisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E kishit pyetje dhe koment bashkisë.

Këshilltar L.Nako: Unë kam 1 pyetje për dekoret dhe shiritat,këto janë një përdorimeshe sepse shikoj që është nje kosto shumë e madhe e shpenzimit te dritave dekoruese 7 milion e 100 mij lekë është kosto shumë e lartë apo i merni njëherë dhe përdoren gjatë gjithë vitetve te tjera.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ok faleminderit,këshilltare te tjerë?

Këshilltar K.Zguri: Unë kam vetëm një pyetje pse të gjitha fondet janë perqendruar tek pjesa e bizneseve dhe janë përjashtuar te tjera sic mund te jetë Voskopoja për shembull.

Këshilltar E.Bregu: Të nderuar këshilltare,se pari dua te di nëse është një praktike e zakonshme ndryshimi i fondit nga zëri investimeve ne 1 zë që është shpenzimet meqenëse tani jemi në periudhën e buxhetimit me pjesmarrje,ky buxhetim është përcaktuar nga viti i kaluar dhe zërat janë ndarë sipas shumave me kategori. Pra pyetja ime e parë është perderisa ky është parashikuar që është një investim dhe parashikimet për shpenzime të tjera për ta bërë Korcen meqë Korca është atraksion tuistik dhe për ta ndimuar më tej është një praktike e zakonshme apo jo,së dyti shikoj këto zërat që janë bashkarisht si blerje dhe mirëmbajtje,ato zëra janë të vecanët smund t'i përfshijme ne 1 zë,së treti bëhet fjalë për shtëpizat të cilt besoj do te blihen aty dhe nuk e di nëse Bashkia ka blerë vitet e kaluara dhe a i ka gjendje ato ?

Kryetari i KëshillitA.Verushi: Ok faleminderit.

Këshilltare A.Zheku: Pse pikërisht është zgjedhur shuma për investim nga biblioteka "Thoma Turtulli" për të kaluar në funksion të shpenzimit aktual për të cilën ne po flasim,një pjesë të shpenzimit, pse nuk është investuar e para,e dyta mund të mbartet kjo shumë për vitin i ardhshëm dhe pse duhet te lartësojme figurën e "Thoma Turtullit" me aktivitete e te tjera të cilat ne i dimë,qytetarët i dinë dhe përse këto para ti meren kësaj biblioteke dhe shkojnë për rialokim sipas shpenzimeve të parashikuara.

Kryetari i KëshillitA.Verushi: Nëse ska pyetje tjetër po i jap fjalën kryetarit.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Shumë faleminderit njëhere për mundesinë e kësaj mbledhje jashtë rradhe te Këshillit të Bashkisë. E kemi kërkuar mbledhjen jashtë rradhe për shkak se jemi të kushëtuar nga përcaktimet e ligjtit per buxhetin ku janë dhënë ndryshimet e zërave buxhetore deri e ne datën 15 tetor prandaj kërkuam këtë mbledhje jashtë radhe. Dua të them 2 fjalë se pse po e kërkojmë këtë ndryshim te zërave te buxhetitit. Në këtë pike bihem dakort që turizmi është një pikë shumë e rëndësishme i zhvillimit të qytetit dhe bashkisë dhe ne jemi investuar në vite per te ndertuar nje profil turistik te qytetit dhe bashkise jo vetem me investime publike po keto investime publike janë ndjekur pastaj dhe nga shuma investime private në struktura që lidhen me turizmin qofshin këto hotele,bujtina po dhe si shërbime si bare dhe restorante. Tani e kam thënë dhe ne mbledhjet e mëparshme kjo situata e turizimit është një situatë dinamike pra nuk është se ne arijme ne një vit të caktuar që të jemi të renditur mirë në drejtim të pozicionit që ne kemi për tërheqjen e turistëve dhe pastaj këtë pozicion e mbajmë të tillë edhe pa bëer investime dhe pa e vrarë mendjen për tu përjekur për tu bërë inovator dhe për tu përshtatur kushteve. Pra situata është dinamike dhe ne rast se Korca si bashki ose si qytet do që të ruaje atë pozicion që ka si një destinacion i rëndësishem ne Shqipëri dhe pse jo te tentoje dhe ta shtojë numrin e vizitorëve dhe turistëve duhet te përpiqemi ti përshtatemi situatave,situata e tanishme është qe ju shihni nuk është më si para disa viteave ku ne ishim te parët që filluam rrugën e ndryshimit të transformimit te qytetit dhe bashkisë edhe këtë profilin e nje qyteti te eventeve dhe për këtë arsye erdhën shumë vizitorë vendas por edhe te huaj,tani situata ka ndryshuar shumë qytete të tjera jo vetëm në pjesa e bregdetit por edhe pjesa e brendshme e vendit qe kanë edhe potenciale te trashëguara ti quajmë mbase dhe me te mëdha se Korca sic jane Berati,Gjirokastra dhe ato po përpiqen të ndjekin këtë filozofi po investohet brenda strukturës te qyteteve dhe po investohet edhe në këtë profilin e organizmit te eventeve dhe të festave dhe të organizimive të tjera me qëllim për të tërhequr njerëz pra e thenë e përmbledhur konkurenca është rritur shumë dhe ne rast se ne duam

te jemi destinacion turistik ne Shqipëri duhet edhe ne ti përshtatemi kushteve te kohës,kjo është situata e përgjithshme. Tani Korca është një bashki edhe një zonë e cila turizimin e ka te shpërndarë gjatë gjithë vitit me luhatje të caktuara por kuptohet që fluksin më të madh turistik e ka në periudhën e dimrit pra me festat e fundvitit duke filluar nga festat e nëntorit për të vazhduar më pas me krishtlindjet dhe duam që me këtë buxhet që po rialokohet të bëjmë një shtim të numrit të aktiviteteve në këtë periudhë por edhe 1 ndryshim të dekorit nuk është se në vitet e tjera kemi investuar shumë krahasuar me qytetet e tjera qe nuk e kanë këtë profil turistik e Korcës edhe këtë e kemi bërë diskutim edhe me stafin e bashkisë. Po te shohim sesa harxhon për dekor nje qytet ne mes te Shqiperisë qe nuk e ka këtë profil turistik dhe sa kemi harxhuar ne janë shifra 1/3 ose 1/4 e buxhetit të themi,tani ka erdhur koha që duhet të investohet pak me shumë me qëllim që ta kemi Korcën përsëri qëndren e investimeve dhe të ardhjes të fluksit të vizitorve në periudhën e fundvitit në rast se nuk e bëjmë këtë gjë kemi riskun që këto flukse njëzësh të shpërndahen gjithandej nëpër Shqipëri kjo është situata e përgjithshme tani un po ju përgjigjem këtyre pyetjeve mbase më shpëtoi ndonje element. Tani pyetja e Lazjonit po qëndron si diskutim domethënë për të ofruar një shërbim të caktuar ne si bashki kemi 2 opsione ose ti ngreme kapacitetet brenda nesh dhe ta bëjmë vete ose te haucosh ta marim me qera dhe kjo vlen kjo vetëm për pjesën e dekorit po cfarëdolloj shërbimi mund ta bëjmë veët ose mund ta haucosh edhe ne transportin urban mund ta bëjmë vet ose mund ta haucosh domethënë cdo lloj gjëje ne parim ne mund ti ngrem kapacitetet vet por është një cik ajo masa e deficiencës sesi bëhet me mirë jo gje nuk është puna vetëm e blerjes të këtyre kapaciteteve por kërkon edhe pjesën e profesionistëve dhe do një llogari sepse këto foni ndricimi e të tjera kur janë njëcik me profesionale sepse kemi pasur më parë tek qendra e kulturës kapacitete të vogla jo për evente të mëdha tani kur kalon më pas kur kalon ne pjesën e evenimenteve më të mëdha filon ajo pjesa e ekonomise te shkallës sa evente bën ti ne vit që të justifikojë blerjen edhe marjen pastaj të profesionisteve se nuk është vetëm blerja e këtyre sendeve duhet edhe njerëzit qe i punojnë dhe hyn ajo ekonomia e shkallës sepse ai qe i ka kapacitetet e ngritura nuk punon vetëm me bashkinë por punon edhe për dhjetra aktivitete të tjera gjatë vitit dhe po ti ngremë në këto kapacitete do një llogaritje por e kemi parë që është më e udhës ti marim me qëra ne momentet kur na duhen sesa ti investojme vet pra llogjike jonë për këtë infrastrukturë që po flasim foni,ndricim ka qënë që dicka të vogël ta kemi këtu ne bashki dhe pjesën tjetër që kërkon investim më të madh ta marim me qëra dhe besoj se e njëjta llogjike është gjithandej por një llogaritje do të bëhet për të ardhmen në parim është kjo që sapo thash. Nje pyetje ishte për materialet e dekorit përgjithesisht këto shiritat dekorues tani këto janë materiale konsumuese nuk është se janë njëpërdorimshe por nuk është se janë as te përjeteshme pra ne perpiqemi ti vendosim dhe ti heqim me kujdes dhe të ruajme sa me teper nga 1 vit ne vitin tjetër po gjithnje ka 1 sasi e cila demtohet eshte e pashmangshme tani unë ju kam kërkuar këtyre te pjesës të stafit të cilët meren me dekorin që ne te përpiqemi të kemi disa elemente të dekorit të cilët janë definitive le ti quajmë ose me jetë me te gjaët se definitive nuk ke asgjë nga këto me drita sepse digjen por të kemi dicka me jetë më të gjatë. Dhe në mos gaboj atje në bulevardi Republika strukturat e ndricimit janë me jetë me te gjatë, dora dorsë do përpiqemi nga viti ne vit të indetifikojmë modele dekori që janë më të qëndrueshme dhe me jetë gjatësi më të madhe dhe pastaj me pjesën tjetër shiritat ndricues të tregojmë kujdesin maksimal që ajo pjesë që mbartet ne vitin tjetër të jetë sa më e madhe por nuk është asnjëher 100%. Per sa i përket kërkeses të Kostiti për të bërë dhe një lloj zbukurimi në Voskopoje unë mendoj që është dicka e mirë do e kemi parasysh mirë është që dora dorës përvec qytetit të Korcës do ketë atë peshën kryesore të zbukurimit edhe për këto fshatra me potencial turistik ku Voskopoja është kryesorja duhet të ndërhyjme me elemnte të dekorit pasi

fluksetet e njerzve që vijnë në fundvit nuk qëndrojnë veëtm ne Korcë por qëndrojnë edhe nëpër këto fshatra edhe atje duhet te ketë atmosferë festash të shohim c'mund t bëjme. Për sa i takon pyetjes se pse këto zëra janë kaluar nga investimi në shpenzim.

Këshilltar E.Bregu: Pyetja është a është praktike normale?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Jo nuk është praktike normale,por nuk ka një rregull të shkruar duhet të kalojm ose jo, domethënë kemi marrë një vendim që këtë vit duhet të bëjmë një ndryshim në pjesën e dekorit dhe aktiviteteve të fundvitit me qëllim që Korcën ta bëjmë kryeqendrën e festimeve të fundvitit dhe kjo nuk bëhet me ato përpjekje që kemi bërë deri tani është rritur shumë konkurenca dhe tani duhet të përpiqemi të gjithë së bashku ta rikthjme vemendjen fillimisht në sezonin e dimrit dhe me pas gjatë gjithë vitit duhet ta vrasim të gjithë mendjen sesi ta rikthejmë vemendjen reth Korcës kshu duhet parë kjo përpjekje. Edhe mund ta lija fare me atë ashtu si ishin parashikuar dhe ok,por them që duhet të jetë një përpjekje e përbashket qoft edhe për hatrë të atyre individeve dhe familjeve që janë te punësuar ne turizëm apo te atyre bizneseve që kanë investuar ne sektorin e turizmit,nuk është një gjë e shkruar që duhet të kalojne ose jo ne kemi parë kemi thene që na duhet x fond për të realizuar këët që duhet për pjesen e dekorit ose eventeve dhe kemi parë ku jane mundsitë për të bërë rialokimet e këtyre fondeve. Një pyetje me shpëtoi ajo e mezit kjo ishte e para e treta ishte blerja e shtëpive keni gjendje apo jo, jo nuk kemi gjendje i kemi marrë me qera dhe në mungesen e shtëpive po vijmë në ajo e propozimit të Lazjonit në rast se deri tani shtëpizat e drurit i kemi marrë me qera kemi gjykuar meqënëse i përdorim në disa aktivitete ti kemi te bashkisë kështu është kjo Lazjon rast pas rasti duke parë shkallën e përdorimit gjykon.

Këshilltar A.Hapi: Përshendetje te gjithëve në lidhje me këtë pyetje se e kisha shënuar dhe unë, nuk është permentim i plotë nuk është permentim final kjo është perlllogaritje e kostos qe do t duhet për të blerë patinat për mirembajtjen e pistes të patinazhit që cdo vit ka nevojë që ndërmarja e di shumë mirë kostot që ka dhe për rregullin që ka sic u bë dhe në komision se bëmë dicka shpjeguese më shumë,me te qartë. Rregullimet dhe miërmbajten kanë të bëjnë dhe me antifrizen që cdo vit shtohet pra ky zë i përfshin të gjitha por kuptohet që kur të viëj koha e prementimit këto zëra do jenë të ndarë të detajuara.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Ok ja ta shpjegoj dhe këtë domethënë,si praktikë ne miratojme ne këshill këto grupet e zërave madje ai detajim mund të ishte pak me i trashe i trashe ne kuptimin që grupe zërash më të pergjithshme sic ishte në ai materiali që u dikskutua në komisione po pastaj me kërkesën e komisionit sollëm një material më të detajuar kurse detajimi përfundimtar do të bëhet me urdhër të kryetarit të bashkisë sic e përcakton edhe ligji i buxhetit pra këshilli miraton këto blloqe kryesore kurse detajimi ne imtësi bëhet me urdhër të kryetarit dhe më pas kuptohet ne varsëi te vlersë për cdo gjë ndiqet edhe procedura për ta marë këtë shërbim apo për ta bleër këtë mall pra ndiqet pocedura përkatese kjo është radha këshili miraton zërat kryesor detajimi bëhet me urdhër te kryetarit dhe me pas ndiqet procedura e prokurimit.

Këshilltar E.Bregu: Jam shume dakort me këtë por aty jane 2 bloqe të ndryshme të përfshira ne 1 bllok sepse është blerje dhe mirembajtje si parim nuk mund te futen ne 1 bllok,pergjigjia e dhene

nga ana juaj nuk është korekte sepse po beni ngarkese te qellimshme po perfshini disa zera ne 1 bllok.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po kush është qëllimi i kësaj ngatërese?

Keshilltar E.Bregu: Atë gjë e di ti jo unë,unë bëj vetëm konstatimin që janë 2 blloqe të ndryshme dhe cdo njeri që është ktu e kupton dhe e llogjikon që janë 2 blloqe të ndryshme,në 1 bllok të perfshirë 2 zëra është gabim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të dëgjojmë edhe Erjonin për 1 mendim.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Më fal kisha dhe 1 pyetje ti përgjigjem dhe asaj, pyetja e fundit lidhet me kalimin e këtij fondi nga 1 zë që ne kishim lënë për biblioteken 'Thoma Turtulli',tani ai parashikimi yne tek ai zëri për biblioteken 'Thoma Turtulli' parashikon një investim të bashkisë tek ky objekt për ta kthyer në një qendër të teknologjise dhe ofrimit të kurseve dhe ofrimin e kushteve të ndryshme të teknologjisë kryesisht te femijeve deri në moshen 15 vjet pra do e jetë i njëjti model që ne kemi bërë ktej biblioteka e re ku krahas ofrimit të shërbimit klasik të bibliotekës pra leximit të librit ne kemi ofruar atje dhe elemente që lidhen me teknologjinë pra kurse të ndryshme trajnimi evente e te tjera,të njëjten gjë duam të bëjmë edhe ne biblioteka 'Thoma Turtulli' deri ne moshën 15 vjet pra ta rinkostruktojmë atë objekt ta pajisimim me bazën e nevojshme materiale,me pajisje të ndryshme dhe kurset e femijëve ti zhvillojme atje. Nuk është se kemi hequr dore nga ky objekt duke qënë se une e kam me shumë qejf por e kmi shtyre pak ne kohë duke patur mundesine që një pjesë të këtij investimi që unë nuk e di se sa të kemi mundësin ta financojmë nga donatoër të tjerë dhe sa kohë nuk e kemi sakëtsuar këtë se çfare pjese do te meret nga donatoret dhe çfarë pjese nga bashkia jemi duke pritur që të mos e bëjmë komplet investimin me fundet e bashkise por nje pjesë te investimit mund ta bejme nga donatore pra kjo është ideja biblioteka do rikostruktohet është prioritet i yni thjesht e kemi shtyrë pak.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Kryetar,Erjon fjala për ty.

Këshilltar E.Nexhipi: Faleminderit Kryetar, unë do filloj nga fundi mesa di unë dhe prioritetet e caktuar qe duhet te këne Shiptarët ne qytetin e Korçës lidhet me projektetet si smartcity dhe besoj se do jëtë e mundur qe investimi te bëhet i plot,projektet e Bashkimit European dhe per sa i takon strategjisë te përdorur ne lidhje me këtë çështje ne kemi pasur vazhdimisht diskutime ne këshill qe duhet te kalojmë nga qëramarja ne investim dhe ky fond është i kombinuar ka ende shpenzime qe do te konsiderohen shpenzime vetëm për te vjetrën ka dhe investime qe do i rezistojne kohës,ne këto investime që mund te jene me karakter afatmesëm ose afatgjatë unë do te konsideroja kjoskat patjeter që dot të këne nje perdorim afatgjat mbase mbi 10 vjet,patinat 3-4vjet apo 5 vjet,ndriçimi duhet te tregohemi koshiente qe sado te tregohemi te kujdesshëm me montimin edhe ne shtëpit tona sado te mira ti kemi marë nga viti në vit kërkon rinovime por jam i sigurt që ne rastet e modeleve te duhura si struktura metalike të parapërgatitura apo modele sic kemi parë disa versione dhe në qytetet e tjera por edhe ketu tek ne si rasti i Bulevard Repubikes nuk është shpenzim i këtij viti por do jetë shpenzim kohë pra për mua duhet mbëeshtetur si investim sepse nuk është 1 investim i thjesht por është për te qendruar ne ate tregun e turizmit ne

jemi dëshmitare që investimet ne turziem nga qytetarët nga investoret qofte dhe jashte Korçe pa patur dallim krahu politik janë te konsiderueshme dhe me te drejtë ne ate anen e investimit ose prishmeritë e investimit kanë kërkesë te shtuar se cilat jane aktivitetet e pushtetit vendor qe do mbështese për te nxitur turizëm. Ne jemi dëshmitare te viteve te kaluara që kur qyteti ka pasur një ndriçimim ndryshe dhe aktitetet e tjera perveç ndriçimit,kemi qënë në qënder te mediave nderkombëtare dhe kjo kuptohet drejt fluksit dhe jep shpreës per keta investitore qe investimet e tyre nuk do tkuren ne te ardhmen por do te shtohen. I ftoj keshilltarët qe ta votojne pavarsisht objeksioneve apo sqarimeve qe asnjëher nuk shterojne te gjithë ne unë i pari mund te kem pyetje sesi do jenë këto patina për shembull do jenë me mbrojtëse gjuri apo jo por sbesoj se vlene keto diskutime per qelimin me madhor qe ka ky material. Faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Erjon,nese nuk ka asnje koment tjetër nga këshilltarët.

Këshilltar D.Osmani: Pasi grupi jonë është njohur edhe me kete material e vlerësoj qe pjeësërisht qe ky investim duhet bërë,duhet bërë por i kërkoj dhe Kryetarit dhe këshillit dhe te gjithë për problemin e trurizmit ne duhet i mëshojme gjithe vitit jo vetem fundit te vitit apo edhe fundjavave sepse vertet është nje fluks i turizmit te shtuar ne korce por kjo është me shume fundjavave ndodh ne shume pak dite dhe te gjithë ne jemi koshiente qe problematikat e mbajtjes dhe kostot e hoteleve apo gjithe struktures te turizmit ne qytet jane te larta do te ishte mire qe te mendohej nga kryetari i bashkisë nga stafi i bashkisë nga te gjithëh ne qe ta ritimi fluksin ta ritim gjate ditëve te tjera jo vete ne fundjave,mora nje pergjigje nga kryetri per sa i perket pyetjes qe kisha dhe kundrështimit tim per sa i perket bibliotekes te fëmijeve qe per mendimin tim nuk duhet te hiqej sado e vogël te jete ajo vlere ai investim duhet berë nuk e di pse ky investim nuk është bere deri me sot sepse nuk e mendoj qe ky investim i madh qe kryetari na deklaroi ka te bejë me kete fond është fondi goxha me i vogël sesa investim dhe nuk mendoj qe ky fond duhet te shkojë per keto zrëa. Per pjesen tjetër per sa i perket investimit tuaj duhet te mendohet seriozisht qe kjo nuk duhet te jetë vetëm per pjesën e fundit te vitit. Faleminderit.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë shpjegova po mbase ju nuk u kuptuat ne ishim përgatitur qe këtë investimin tek Bibloteka ta bënim vetë me fondet e bashkisë,tani kemi parë keto kohë qe mund te kemi mundësi ne per ta financuar nje pjesë edhe nga donatorë te tjerë qe mos hyme ne detaje te këtyre donatorëve,domethënë ne ishim përgatitur per te financuar vet 30 milion lek dhe per rikonstrukionin dhe për pajisjet tani kemi parë ne total keto kohët e fundit qe 1 pjese e këtij burimi mund te financohet edhe nga burime te tjera dhe nuk ka nevojë qe ti beje komplet bashkia sesa fiks unë nuk e di mbase mund te jetë komplet kjo qe po heqim mbase mund te jetë nje pjesë me e vogël, ne rast se është nje pjesë më e vogël per buxhetin tjetër do ta shtojme ate vlerë. Bibloteka patjetër si institucion do te riskstrukohet bashkë me pajisjet dhe rikthimin ne këtë qendër të trajnimit përveç funksionit te biblioteks prë fëmijet deri ne moshën 15 vjet per disiplina qe lidhen me teknologjinë. Për sa i takon këtij diskutimi te bëre ne lidhje me ecurinë e turizmit

ne vazhdimsëi me vjen shumë mirë që e dëgjoj dhe nga ana juaj që duhet një vëmendje e shtuar e turizmit dhe është momenti tani që ta vrasim shumë mendjen se çmënd të bëjme që ta bëjme këtë fluks turistsëh deri me tani dhe të shtojmë të tjera. Ne jemi pjesë e një projekti të financuar nga Bashkimi Europian 4 bashkitë e Shqipërisë njëra prej të cilave është Korça dhe do të bëhet një studim i thelluar lidhje me këto bashki për strategjinë e zhvilluar në lidhje me sektorin e turizmit dhe besoj në këtë kuader jeni të ftuar edhe ju të bëheni pjesë e tryezave që do organizojmë, Lazjoni për shembull është pjesë e këtij grupi ku ne diskutojmë këto problematika apo sfidat e turizmit edhe ju patjetër jeni të ftuar individualisht ku mund të bëjmë diskutime këto në këshill sepse realisht vlen. Ajo që mund të themi është që kërkohet veprim, të vrihet mendja që ta bëjmë Korçën destinacion turistik sepse konkurrenca është e madhe pozitive është që vëmendja kundrejt Shqipërisë është rritur dhe ne duhet të përqijemi që rajoni julindor përfshirë edhe Korçën të mos ngelet jashtë këtyre flukseve të shtuar të vizitoreve që erdhën këtu vit për vit tjetër jam i sigurt që do vijmë me tepër dhe me tepër tani duhet të përfshihemi dhe të marim maksimumin nga energjia dhe nga leket që këtu vizitorët do të harxhojnë në Shqipëri pra sjellja e turistëve të huaj në Shqipëri është një sfidë, marketingu është 1 sfidë, shtimi diversifikimi i produkteve është një sfidë tjetër, rajonalizmi pra qasja e secilit rajon ndaj turizmit duke shtuar ose duke qenë komplementare, plotësues se çfarë ofron një bashki çfarë ofron një bashki tjetër e rajonit këtu janë pika.

Këshilltar I. Bode: Unë jam shumë dakort që të investohet për shkak edhe të asaj që u tha konkurrenca me qytetet e tjera, e të tjera ajo që mua më shqetëson më shumë të drejtën është që ky fond prej 100 e 3 milion lek të vjetra që do të shtohet buxhetit për mirëmbajtjen e shërbimeve publike është që ky buxhet po i shtohet një ndërmarrje drejtuesi i se cilës është i dokumentuar që ka bërë shkelje dhe shpërdorime fondesh dhe të gjitha me radhë dhe mendoj që kjo i jep përgjigje dhe asaj sesi menaxhohen këto materiale, çfarë niveli është ai koeficienti i konsumit dhe i dëmtimit që të jetë sa më i ulët, kështu që ky është një shqetësim që për mua është goxha i madh nuk e di sesi do të menaxhohen këto fonde që i shtohen kësaj ndërmarrje por deri me sot kemi parë që ka abuzime dhe ka shpërdorim.

Kryetari i bashkisë S. Filo: Më fal, një pyetje ku e keni parë këtë që është e dokumentuar shpërdorimi tek ndërmarrja?

Këshilltar I. Bode: Besoj të gjithë e kemi parë, është edhe në raportin e kontrollimeve të shtetit në media e kemi parë dhe nuk kemi marrë një sqarim që është e vërteta nëse qëndrojnë këto gjëra apo jo ato sygjerrime që ju keni marrë nga raporti nga kontrolli i lartë i shtetit masat që ju duhet të merrni janë marrë së bashku me radhë.



Kryetari i bashkisë S.Filo: Ne fakt nuk ishte kjo pika e ditës po unë do ju jap nje sqarim,tani e para ju jeni këshilltare e këshillit te bashkisë dhe nuk ka arsye qe informacionin apo konkluzionet qe ju merni te jenë te bazuar mbi kete pikë mbi lajmet qe ju merni nepër portale sepse nuk jeni njerëz qe nuk keni akses për te marë informacione,ju jeni këshilltare dhe te thuash ne këshill qe unë kam arritur ne konkluzionin që ka shpërdorim te detyrës sepse e pashë në media sme duket as etike as logjike. Te gjithë ju këshilltare keni te drejtën ligjore qe te merni cdo informacion zyrtar dhe te saktë per keto çështje dhe meqenëse e hapem kete çështje po ju jap një informacion ne lidhje me raportin e fundit te kontrollit te larët te shtetit,domethënë do me thuash ti se cilën nga ato pika duhet te sqaroj apo do ma thuash ti. Cilën nga pikat e raportit ke nevojë të të sqaroj?

Këshilltar I.Bode: Per te bere nje sqarim nuk thash qe jm bazuar ne lajme apo portale.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Sapo më the qe e kemi parë ne media.

Këshilltar I.Bode: Thashë është bërë dhe mediatike, unë di qe tek pika ku thuhet per shpërdorimin e karburantit te makinave,me vjen keq nuk e mbaj mend ta gjej tani por duhet te meren masa qe keta zotërinjte qe shkaktojne ketë dhe nuk thashë qe unë jam bazuar ne media thashë ajo është ne kontrollin e lartë të shtetit dhe thashë tjetrën qe po i shtojme fondin një ndërmarje drejtuesi i se cilsë ne raportin e lartë te shtetit rezulton qe ka berë abuzime dhe shkelje me fondet.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Atëhere po te jap unë nje sqarim per çështjen qe ta dish per cfarë flitet,po ta them unë sepse i kam ndjekur edhe nje pjese te deklarave te opozitës per këto raporte per kontorllin e lartë te shtetit. Kontrolli i lartë i shtetit është nje instiucion shumë i rëndësishem ne Republikën e Shqipërisë dhe ne i marim me shumë seriozitet dhe raportet e kontrollit te lartë te shtetit dhe rekomandimet,i mbajmë me shumë seriozitet i verifikojmë dhe më pas dhe reagojmë dhe veprojmë ne varësi te gjetjeve qe kemi. Tani atje ishin 2 pika kryesore besoj une këtyre te dyjave duhet tju referohem nje ishte me përdorimin e nje sasi asfalti pra kontrolli i lartë i shtetit nje sasi asfalti ishte berë hyrje ne daten x dhe ishte berë daje pas 7 diëtsh, 8 ditësh ska rendesi dhe kontrolli i lartë i shtetit doli ne konluzionin qe kjo sasi asfalti është prishur, është hedhur po ajo qe ne i sqaruam kontrollit te lartë te shtetit ishte qe po ky gabim ekziston po ishte ne dokumenta,pra ne dokumenta është berë hyrje sot dhe dalje pas 7 ditësh por ne fakt ky eshte nje gabim vetëm ne dokumenta dhe sasia e asfaltit është e hedhur dhe është ngritur edhe nje grup verifikimi nga ana e kryterit te bashkisë dhe ja u kam kërkuar dhe kontrollit te lartë te shtetit qe aritët n ketë gjetje tani beni verifikimet se kjo është e thjeshte asfalti nuk eshte nje gjë që e mer me vete dhe humbi hajde te verifikojmë se ku jane rrugët qe jane asfaltuar dhe përputhet sasia e asfaltit me hyrjet dhe daljet dhe me sasinë që eshte hedhur ne rrugë se rrugët atje janë,kontrolli nuk u mor me ketë verifikim pra u mor vetëm me anën dokumenatre ajo që unë mund te them pas verifikimit edhe me grupet ne terren dhe me procesverbalin zyrtar ishte që po gabim ne anene dokumentare por nuk tha shperdorim ne fondin e asfaltitit,kjo eshte rasti i pare ne rast se doni mund tju jap procesverbalin apo te shkoni dhe ne vend te shihni rruget qe jane asfaltuar me ate sasi asfalti. Rasti i dyte lidhet me nje sasi karburanti ku perseri ishte nje

gabim nga ana dokumentare u pretendua qe ishte perdorur vete nga ana e drejtorit te ndermarjes te sherbimeve publike sepse kishte firmosur vetem drejtori ne kete dokumentacionin justifikues sipas karburantit nderkohe qe sipas sygjerimit te kontrollit qe ne,sepse kontrolli duhet te kuptoni qe detyra kryesore e kontrollit eshte qe te verifikojte praktikat dhe te na orinetojne ne qe keto praktika ti veme ne rrugen e duhur dhe per ket evlen shume patjeter dhe kjo gje eshte korigjuar qe ne momenti i kontrollit dhe ne vazhdim ne ajo fleta e udhetimit firmosin edhe te gjith personat qe udhetojne nderkohe qe me pare firmosin vetem drejtori por leviznin edhe punojes te tjere te ndermarjes me mjetin e ndermarjes kjo nuk ishte gjetja dhe siutata e kontrollit pra gjith levizjet qe kishte bere makina e ndermarjes per shkak se kishte firmosur vetem u tha qe ka levizur vetem drejtori ne fakt nuk ishte keshtu dhe kjo gje eshte korigjuar pra ne te dyja rastet konkluzioni im pasi kame pare raportin pasi kam degjuar edhe punojesit e bashkise pasi kam bere edhe verifikim ne teren pra verifikim te praktikave ka qene qe po ka gabime administrative qe duhen korigjuar pra fletedalje ska pse behet gabim por shte gabim administrativ. Tani une po te sqaroj meqenese me pyete dhe shume mire bere qe me pyete dhe me dhe mundesine te te sqaroj sepse i kam pare dhe ato deklaratat e fushates patjeter qe ato qe jane gabime duhen pranuar por masa e reagimit masa qe mar une eshte ne raport me gabimin qe une e shoh te provuar po ka gabim administrativ dhe per kete punojesit kane mare veretje dhe kane mare detyren te korigjojne dhe ti ushtojne shume vemendje praktikes dhe letrat jane shume te rendesishme ti mund ti besh punet por dhe letrat jane shume te rendesishme,pra ti mund te besh shperdorim ne kuptimin humbje apo prishje te materialeve nuk ka patur dhe kete une jam gati ta shoh dhe nga ju hajdeni grup pastaj jane rruget atje ato qe jane asfaltuar.

Këshilltar I.Bode: Jam dakort pjesërisht.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Pse pjesërisht dhe kjo plotësisht?

Këshilltar I.Bode: Po si mund të verifikohen një shpërdorim karburanti, domethëne si mund ta gjejm?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Atëhere edhe njëhere materiali i kontrollit ishte ky per shkak se ne fleten e udhetimit ka firmosur vetëm drejtori atëhere i bie që me këtë makine ka lëvizur vetëm drejtori, ky ishte argumenti. Tani pyetje te tjera për këtë ceshtje jo , e kjo ishte tëresisht jashtë çështjes por u zgjata aq sa mban kandari kur i thone nje fjale. Drejtori dhe institucioni është i detyruar të zbatojë procedurat ligjore të prokurimit që parashikon ligji dhe kjo do ndodhe pa asnj lloj diskutimi edhe ne rastet e tjera e dhashë këtë sqarim meqenëse e keni pasur problem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos flisni pa leje.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Duhet të ndejkim praktiken patjetër për këtë ceshtje që ti ngrite mund të kërkoni informacion më të detajuar sepse nuk mbajmë ndonjë informacion të fshehur për asnjë aq më tepër për këshilltaret nuk bëhet fjalë dhe ne rast se ju gjykoni që ka shpërdorime të kësaj natyre që ju flisni ju e keni dhe detyrim ligjor si qytetar jo si këshilltare t'ju drejtoheni dhe organeve të tjera tani pse e mbani kështu mediatike këtë gjë verifikoheni dhe ka organe se ku shkohet ja po ju sygjeroj unë, shkoni në organe te tjera po q ëmos u merni me fjalë kafeneje, shikojë meri mateialet dhe shko në organet përkatëse.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit këshilltar,faleminderit kryetar besoj se jeni sqaruar sepse jeni jashtë rendit te ditës,atëhere meqenëse pyetjet morën përgjigje unë mendoj ta hedhim ne votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 34

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kam dhe dicka për këshilltaret duke marë parasysh kërkesat tuaja ne lidhje me orarin e mbledhjes të këshillit bashkiak duke qenë që një pjesë e juaja mëngjesin e kanë njëcik të vyer për shkak të përditshmërisë të punës,mendoj që mbedhja e këshillit bashkiak të radhës por dhe në vazhdim të zhvillohet ne orën 12 besoj që është mjaftushmerisht,nëse do i marim tek e tek asnjëher nuk do darkotesohemi kështu që mendoj të jetë ora 12, e dyta që kam meqenëse këshilli ka një buxhet i cili ende nuk është konsumuar mendoj dhe jam due u përpjekur që të bëjme një shkëmbim eksperiencash me këshillin bashkiak meqenëse jemi ne 1 linje Lezhë dhe Shkodër. Jeni dakort që ta fillojme këtë komunikim me këshillat bashkiak të dy qyteteve.Dhe e treta që kam zonjat këshilltare pesë minuta kohë për tu takuar me njëra-tjetër sepse jemi ne një muaj shumë të rëndesishëm që është tetori roze edhe të mendojme për ndonje aktivitet që mund të zhvillojmë ne si gra këshilltare.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**  
**ANA VERUSHI**